





YASMINA REZA  
**ZOTI I MASAKRËS**  
KOMEDI

---

BOTIMET TOENA



YASMINA REZA

# Zoti i masakrës

- komedi -

*Përktheu nga origjinali frëngjisht*

Nasi Lera

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2017

Autorja: Yasmina Reza (Jesmina Reza)  
Titulli në origjinal: Le dieu du carnage  
Botoi në frëngjisht: Albin Michel

Cet ouvrage, publié dans le cadre du Programme d'Aide á la Publication du Service de Coopération et d'Action culturelle de l'Ambassade de France en Albanie, bénéficie du soutien du Ministère français des Affaires étrangères et du Développement international

Ky libër, i botuar në kuadrin e programit të ndihmës për botim të Shërbimit për Bashkëpunim dhe Veprim Kulturor të Ambasadës së Francës në Shqipëri, ka mbështetjen e Ministrisë Franceze të Punëve të Jashtme dhe të Zhvillimit ndërkombëtar.

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo  
Korrektore letrare: Arlinda Rrushi  
Përkujdesja grafike: Elida Stafa

ISBN 978-9928-235-56-5

© 2007, Editions Albin Michel et Yasmina Reza

© *në shqip* Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjolleasha", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

E-mail: [redaksia@toena.com.al](mailto:redaksia@toena.com.al)

[botimet.toena@gmail.com](mailto:botimet.toena@gmail.com)

[Http://www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

VERONIKA HULIE

MISHEL HULIE

ANETA REJ

ALEN REJ

(Midis të dyzetave dhe të pesëdhjetave.)

Një sallon.

Nuk ka realizëm.

Nuk ka përbërës të kotë.



*Hulietët dhe Rejtët të ulur përballë njëri-tjetrit.*

*Kuptohet menjëherë se ndodhemi te Hulietët dhe se të dy çiftet sapo janë njohur me njëri-tjetrin.*

*Në qendër, një tryezë e ulët, mbuluar me libra arti.*

*Dy buqeta të mëdha me tulipanë të vendosur në dy vazo.*

*Mbretëron një atmosferë hijerëndë, e çiltër<sup>1</sup> dhe mirëkuptuese.*

VERONIKA: - Sigurisht, ne do të bëjmë deklaratën tonë dhe ju do të bëni deklaratën tuaj... Deklarata jonë është kjo: “Më 3 nëntor, në orën shtatëmbëdhjetë e tridhjetë, në kopshtin *Aspirant-Dynan*, pasi u grindën me fjalë, Ferdinand Rej, njëmbëdhjetë vjeç, armatosur me një shkop, goditi në fytyrë djalin tonë, Bruno Hulien. Pasojat e këtij veprimi janë, përveç ënjtjes së buzës së sipërme, dy dhëmbë të thyer, ndërsa është prekur edhe nervi i dhëmbit të djathtë”.

ALENI: - I armatosur?

VERONIKA: - I armatosur? Nuk ju pëlqen “i armatosur”? Mishel, mos është më mirë të vëmë në vend të “i armatosur”, i pajisur me një shkop?

ALENI: - Po, i pajisur.

MISHELI: - I pajisur me një shkop.

---

<sup>1</sup> Gjithë mirësjellje (të gjitha shënimet janë të përkthyesit).

VERONIKA: (*Duke korrigjuar.*) - Pajisur. Ajo që e bën qesharake gjithë këtë ngjarje është se kopshtin *Aspirant-Dynani* e kemi parë gjithmonë si një strehë të sigurt, ndryshe nga parku *Monsuri*, që nuk është aspak i tillë.

MISHELI: - Po, po, është e vërtetë. Ne i kemi thënë gjithmonë djalit tonë: “Nuk do të shkelësh kurrë në parkun *Monsuri*, ndërsa në kopshtin *Aspirant-Dynan* mund të shkosh sa herë të duash”.

VERONIKA: - Kështu i kemi thënë gjithmonë, por... Sidoqoftë, ju faleminderit që erdhët. Po u bërë pre e logjikës së verbuar nga pasioni, nuk fiton asgjë<sup>2</sup>.

ANETA: - Jo, jo, jemi ne që duhet t’ju falënderojmë.

VERONIKA: - Nuk kemi përse të falënderojmë njëri-tjetrin. Për fat, arti i bashkëjetesës nuk është zhdukur ende, apo jo?

ALENI: - Por, që me sa duket, fëmijët nuk e kanë përvetësuar ende, dua të them që, fëmija ynë, nuk e ka përvetësuar ende.

ANETA: - Po, që fëmija ynë nuk e ka përvetësuar!... Ç’do të bëhet me dhëmbin, të cilit i është prekur nervi?...

VERONIKA: - Nuk e dimë. Nuk na është thënë prerë se ç’do të bëhet. Ka të ngjarë që nervi të mos jetë tërësisht i zbuluar.

MISHELI: - Ka mbetur zbuluar vetëm një pjesë.

VERONIKA: - Po. Një pjesë e nervit ka mbetur zbuluar, kurse pjesa tjetër është e mbrojtur. Tani për tani nuk do ta heqim nervin.

---

<sup>2</sup> Ku emocionet dhe ndjenjat janë më të fuqishme se arsyeja.

MISHELI: - Do përpiqemi që të shpëtojmë dhëmbin.

VERONIKA: - Gjëja më e mirë që mund të bëhet, është shmangia e çarjes së kanalit.

ANETA: - Po...

VERONIKA: - Do të duhet njëfarë kohe për t'i dhënë mundësi dhëmbit të marrë veten.

MISHELI: - Deri atëherë, dhëmbi do të mbrohet me një këllëf.

VERONIKA: - Protezat nuk vihen pa mbushur të tetëmbëdhjetat.

MISHELI: - Nuk vihen.

VERONIKA: - Protezat përfundimtare vendosen vetëm kur ka mbaruar rritja e dhëmbëve.

ANETA: - Sigurisht. Shpresoj që... Shpresoj që gjithçka të shkojë mbarë.

VERONIKA: - Le të shpresojmë.

*Ngurrim i lehtë<sup>3</sup>.*

ANETA: - Tulipanët qenkan shumë të bukur.

VERONIKA: - Na i sjell luleshitësi i tregut në *Mouton-Dyvernet*. E keni parasysh, është ai që e ka dyqanin në majë fare.

---

<sup>3</sup> Heshtje. Subjekti i bashkëbisedimit të mëparshëm është shterë dhe të ftuarit nuk e kanë cekur ende subjektin e mëpastajmë.

ANETA: - Ah, po.

VERONIKA: - Tulipanët mbërrijnë çdo mëngjes drejt e nga Holanda, dhjetë euro një buqetë me pesëdhjetë copë.

ANETA: - Sa mirë!

VERONIKA: - E keni parasysh dyqanin që është në majë fare.

ANETA: - Po, po.

VERONIKA: - E dini që djali ynë nuk donte ta kallëzonte Ferdinandin.

MISHELI: - Nuk donte ta kallëzonte.

VERONIKA: - Ishte me të vërtetë mbresëlënëse të shihje atë fëmijë, që e kishte kyçur gojën, megjithëse i kishte ikur fytyra dhe i kishin thyer dy dhëmbët e parmë.

ANETA: - E marr me mend.

MISHELI: - Ai nuk donte të kallëzonte nga frika se do të dukej si spiun para shokëve, Veronika, duhet të tregohemi të ndershëm, në qëndrimin e tij kishte vetëm guxim dhe trimëri të pashoqe.

VERONIKA: - Sigurisht, por guximi i madh shpalos, gjithashtu, edhe shpirtin e bashkësisë.

ANETA: - Sigurisht... Po, si... Dua të them si arritët tek emri i Ferdinandit?...

VERONIKA: - Ne i shpjeguam Brunos se nuk i bënte aspak mirë duke e mbrojtur atë që e kishte goditur.

MISHELI: - Ne i thamë djalit tonë se fëmija që e goditi, përderisa nuk u ndëshkua për veprimin e tij ndaj teje, mund të vazhdojë të godasë pa u shqetësuar aspak. Si mund të mendosh se nuk do ta përsërisë më atë veprim të shëmtuar?

VERONIKA: - Ne i thamë se po të ishim prindërit e atij fëmije, do të donim patjetër të mësonim çdo gjë.

ANETA: - Sigurisht.

ALENI: - Po... (*Celulari i tij dridhet.*) Më falni... (*Largohet nga grupi; ndërkohë që flet, nxjerr një gazetë nga xhepi...*) Po, Moris, faleminderit që më telefonove. Po, në gazetën *Jehonat* të këtij mëngjesi, po jua lexoj...: “Sipas një studimi të botuar në revistën britanike *Lancet* dhe i ribotuar dje në gazetën *F.T.*, dy shkencëtarë australianë kanë zbuluar pasojat neurologjike të Antrilit, ilaç kundër tensionit të lartë, prodhuar nga laboratorët *Verenz-Farma*, i cili shkakton dobësim të dëgjimit dhe çrregullim të lëvizjeve”... Median nuk e zë asnjëherë gjumi, atë e ke gjithmonë nëpër këmbë, aty, te ju?... Është me të vërtetë acaruese... Por ajo që më acaron më tepër është Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve, që ka për t’u mbledhur pas pesëmbëdhjetë ditësh. I keni marrë të gjitha masat për t’i dhënë një zgjidhje kësaj çështjeje? OK... Moris, Moris, pyete drejtorin komercial, në do të ketë ribotime të tjera... Do flasim përsëri. (*Mbyll celularin.*) Më falni.

MISHELI: - Ju jeni...

ALENI: - Avokat.

ANETA: - Po ju?

MISHELI: - Merrem me shitje me shumicë të artikujve shtëpiakë. Veronika është shkrimtare dhe punon me kohë të pjesshme në një librari arti dhe historie.

ANETA: - Ju jeni shkrimtare?

VERONIKA: - Kam marrë pjesë në një vepër kolektive mbi qytetërimin saba<sup>4</sup>, duke filluar nga gërmimet që nisën në fund të konfliktit midis Etiopisë dhe Eritresë. Në janar do të nxjerr një libër për tragjedinë e Darfurit<sup>5</sup>.

ANETA: - Jeni specialiste për Afrikën.

VERONIKA: - Interesohe me për atë pjesë të botës.

ANETA: - Keni fëmijë të tjerë?

VERONIKA: - Brunoja ka një motër nëntë vjeçe, Kamilën. Ajo është zemëruar me të atin, sepse ai, mbrëmë, nxori jashtë nga shtëpia miun e bardhë.

ANETA: - Keni nxjerrë jashtë nga shtëpia miun e bardhë?

MISHELI: - Po. Miu i bardhë bënte një zhurmë të llahtarshme natën. Janë krijesa që flenë ditën. Brunoja vuante, ai nuk e duronte dot zhurmën e miut të bardhë. Për vete, me thënë të vërtetën, kisha kohë që doja të çlirohesh prej tij, më në fund thashë, boll tani, e kapa dhe e nxora në rrugë. Mendoja se atyre u pëlqenin kanalet, gjirizet, por nuk është aspak e vërtetë, miu u ngul i gjithi në trotuar si të hidhte aty rrënjë. Në fakt, ata nuk janë as kafshë shtëpiake, as kafshë të egra, nuk e di se cili është mjedisi i tyre natyror. Ata ndihen fatzinj edhe po i vendose në një çeltirë. Nuk e di se ku mund t'i vendosësh.

ANETA: - Ju e latë jashtë, në rrugë?

---

<sup>4</sup> Qytetërimi i Arabisë (viti 800 para Jezu Krishtit), figura emblematike e të cilit është mbretëresha Saba.

<sup>5</sup> Rajon në Sudan, në Afrikë, ku lufta civile, tepër vrastare dhe e egër, nisi mbi një konflikt etnik dhe nuk ka reshtur që nga viti 2003.

VERONIKA: - Ai e la jashtë në rrugë dhe donte t'i mbushte mendjen Kamilës se miu ia kishte mbathur me të katra. Por ajo nuk e besoi.

ALENI: - Dhe sot në mëngjes, miu ishte zhdukur?

MISHELI: - Ishte zhdukur.

VERONIKA: - Po ju, ku punoni?

ANETA: - Jam këshilltare për administrimin e pasurive të trashëguara.

VERONIKA: - A mund të shpresojmë... më falni që po ju pyes hapur, që Ferdinandi do t'i kërkojë të falur Brunos?

ALENI: - Do të ishte mirë sikur ata të bisedonin me njëri-tjetrin.

ANETA: - Ai duhet të kërkojë të falur, Alen. Ai duhet t'i thotë se i vjen shumë keq për veprimin që kreu.

ALENI: - Po, po. Sigurisht që duhet t'i thotë se i vjen shumë keq.

VERONIKA: - Por, a i vjen me të vërtetë keq?

ALENI: - Ai e kupton gjestin që bëri, por nuk kupton sa i rëndë është. Është vetëm njëmbëdhjetë vjeç.

VERONIKA: - Në moshën njëmbëdhjetëvjeçare, nuk je më bebe.

MISHELI: - Por nuk je as një i rritur. Si nuk ju nxorëm gjë, kafe, çaj, Vero, mos ka mbetur ende klafuti? Doli një klafuti e mrekullueshme!

ALENI: - Do më pëlqente më shumë një kafe e fortë.

ANETA: - Mua një gotë ujë.

MISHELI: *(Veronikës që po bëhet gati të largohet për të përgatitur kafënë dhe për të sjellë gotën me ujë që i kërkoi Aneta.)* - E dashur, më bëj edhe mua një kafe të fortë dhe sill kalfutinë. *(Pas një heshtjeje të shkurtër.)* Unë kam menduar gjithmonë se jemi veçse një grusht baltinë, nga e cila duhet të bëhet diçka. Ndoshta baltina do të marrë formë vetëm në fund. Po nga ta dimë se ajo do të marrë formë vetëm në fund?

ANETA: - Hëëmmm.

MISHELI: - Duhet ta provoni klafutinë. Nuk është aspak e lehtë të godasësh një klafuti të shijshme.

ANETA: - Keni të drejtë.

ALENI: - Po ju, çfarë shisni?

MISHELI: - Orendi të ndryshme për të cilat ka nevojë përditë një shtëpi: brava, doreza dyersh, tuba bakri, tenxhere, tiganë...

ALENI: - A ecin ndopak?

MISHELI: - Ju e dini fare mirë, ne nuk kemi njohur asnjëherë vite fatlume, kur iu futëm kësaj pune ishte shumë e vështirë. Por, për sa kohë që dal në mëngjes me çantën dhe katalogun e artikujve, do të thotë se puna ecën. Nuk është si tekstilet, që janë në mëshirë të stinëve. Purenë me mëlçi pate e shes më shumë në dhjetor!

ALENI: - Po...

ANETA: - Kur ju patë se miu i bardhë qëndroi si i ngrirë në trotuar, përse nuk e morët në shtëpi?

MISHELI: - Sepse nuk e kapja dot me duar.

ANETA: - Po kur e latë, në trotuar?...

MISHELI: - Nuk e kapa asnjëherë me dorë, deri në rrugë e çova brenda kafazit të tij, të cilin e përmbysa aty, në trotuar, për ta nxjerrë jashtë. Nuk i prek dot me dorë ato kafshë.

*Veronika vjen me një tabaka në dorë. Pijet dhe klafutinë.*

VERONIKA: - Nuk e di kush e kishte futur klafutinë në frigorifer. Ç't'i bësh, Monika i rras të gjitha në frigorifer. Doni sheqer?

ALENI: - Jo, jo. Me çfarë e keni bërë klafutinë?

VERONIKA: - Me mollë dhe dardha.

ANETA: - Me mollë dhe dardha?

VERONIKA: - Është receta ime e dashur. *(Ajo pret klafutinë dhe e shërben në feta.)* Sa keq që është shumë e ftohtë!

ANETA: - Është hera e parë që dëgjoj klafuti me mollë dhe me dardha.

VERONIKA: - Mollë dhe dardha, por këtu ka një hile.

ANETA: - Ashtu?

VERONIKA: - Dardha duhet të jetë më e madhe se molla, sepse dardha piqet më shpejt se molla.

ANETA: - Kjo na qenka.

MISHELI: - Ajo nuk e tregon gjithë të fshehtën e klafutisë së saj.

VERONIKA: - Lëri ta provojnë.

ALENI: - Shumë e mirë. Shumë e mirë.

ANETA: - Shumë e shijshme.

VERONIKA: - ... I hedh edhe thërrime ëmbëlsire me mjaltë, sheqer dhe glikanxo.

ANETA: - Të lumtë!

VERONIKA: - Është një përsosje e klafutisë së Pikardisë. Për të qenë e ndershme, e kam mësuar nga nëna e tij.

ALENI: - Ëmbëlsirë me mjaltë, sheqer dhe glikanxo, është me të vërtetë diçka shumë e shijshme... Të paktën na u dha mundësia të zbulonim një recetë.

VERONIKA: - Mua do të më pëlqente që im bir të mos i humbte dy dhëmbët e parë, që ju të mësonit recetën e klafutisë sime.

ALENI: - Edhe unë këtë doja të thosha!

ANETA: - Ti e shprehe në mënyrë të çuditshme.

ALENI: - Aspak, unë... *(Celulari dridhet, ai vështron ekranin...)* Jam i detyruar të marr... Po, Moris... Ah, jo, nuk keni asnjë të drejtë për të dhënë një përgjigje publike, do të ndizni polemikën... A i janë drejtuar ndonjë gjykatë?... Mmm. Mm... Ç'shqetësime shkaktohen, ç'është ataksia?... Po në dozë normale?... Që kur dihet kjo gjë?... Dhe që nga ajo kohë ju nuk e keni tërhequr nga farmacitë?... Sa është xhiroja?... Ah, po. E kuptoj, e kuptoj... Në rregull. *(Mbyll celularin dhe formon menjëherë një numër tjetër, duke ngrënë i uritur klafutinë.)*

ANETA: - Alen, të lutem, rri edhe pak me ne.

ALENI: - Po, po, ja, mbarova... *(Flet në celular.)* Serzh?... Ata i njihnin rreziqet që para dy vjetësh... Për këtë ka një raport të brendshëm, por, formalisht, nuk është përcaktuar asnjë pasojë e padëshirueshme... Jo, nuk është marrë asnjë masë, nuk i janë drejtuar asnjë gjykatë, në raportin vjetor nuk është thënë as edhe një fjalë... Ecje prej të dehuri, probleme të ekuilibrit, me një fjalë, dukesh sikur gjithë kohës je xurxull... *(Qesh me bashkëpunëtorin e tij...)* Xhiroja, njëqind e pesëdhjetë milionë dollarë... Të mohuara në tërësi... Ai, budallai, donte që të jepnim një përgjigje. Sigurisht që nuk do të japim asnjë përgjigje, përkundrazi, në qoftë se do të ketë ribotime të tjera, mund të deklarojmë se është fjala për një helmim, pesëmbëdhjetë ditë pas Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve... OK. Më merr në telefon... *(Mbyll celularin...)* Të them të vërtetën nuk kam pasur kohë të fus diçka në gojë.

MISHELI: - Merrni, merrni.

ALENI: - Faleminderit. E teprava. Ku e kishim fjalën?

VERONIKA: - Se do të ishte më mirë sikur të takoheshim në rrethana të tjera.

ALENI: - Sigurisht, sigurisht. Pra, këtë klafuti e bën nëna juaj?

MISHELI: - Receta është e nënës sime, por atë e ka bërë Vero.

VERONIKA: - Nëna jote nuk i përzien dardhat dhe mollët!

MISHELI: - Nuk i përzien.

VERONIKA: - E shkreta, do të operohet.

ANETA: - Ashtu? Po nga se?

VERONIKA: - Nga gjuri.

MISHELI: - Do t'i venë një protezë rrotulluese prej metali dhe polietileni. Gjithë kohën vret mendjen për të gjetur se çfarë do të mbetet prej saj kur ta djegin.

VERONIKA: - I keq.

MISHELI: - Ajo nuk do që ta varrosim bashkë me babanë tim. Do që të digjet, dhe hiri të vendoset pranë nënës së saj, që është krejt e vetme në jug. Dy urna që do të bisedojnë përballë detit. Ha-ha!...

*Buzëqeshje të ngrira.*

ANETA: - Bujaria juaj na ka prekur shumë, jemi tepër të ndjeshëm nga gjesti juaj që, në vend ta acarorit gjendjen, u sollët si të mos kishte ndodhur gjë.

VERONIKA: - Singërisht është gjëja më e paktë që mund të bënim.

MISHELI: Po!